



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
ZYRA PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN**

Rr. Jordan Misja, Blv Zhan d'Ark, Tiranë, adresë web: www.gjykata.gov.al

Datë 23.01.2026

NJOFTIM PËR SHTYP

Referuar interesit të shfaqur nga disa gazetarë, komunikohet informacioni zyrtar në vijim:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Penale, mori në shqyrtim kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për Vleftësimin e arrestit dhe Caktimin e masës së sigurimit ndaj personave nën hetim F.K., L.S., dhe A.V..

Gjykata, me vendimin e saj, të arsyetuar në mënyrë të përmbledhur, ditën e sotme, pasi ka dëgjuar palët e pranishme në seancë, si dhe ka shqyrtuar të gjitha faktet, të dhënat, shpjegimet, qëndrimet, si dhe provat e paraqitura nga palët, në bazë dhe për zbatim të nenit 244, 228, 229, 230, 238 të Kodit të Procedurës Penale:

V E N D O S I:

1. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë, të kryer nga policia gjyqësore më datë 20.01.2026, ora 14:40, ndaj personit nën hetim **F. . K.**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale **“Moskallzim i krimit”** të parashikuar nga **neni 300 i Kodit Penal**.
2. Caktimin si masë sigurimi personal atë të **“Arrest në burg “**, parashikuar nga **neni 238 i Kodit të Procedurës Penale**.

3. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë, të kryer nga policia gjyqësore më datë 20.01.2026, ora 15:00, ndaj personit nën hetim **L. . S. (G.)**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale **“Moskallzim i krimit”** të parashikuar nga **neni 300 i Kodit Penal**.
4. Caktimin si masë sigurimi personal atë të **“Arrest në burg”**, parashikuar nga **neni 238 i Kodit të Procedurës Penale**.
5. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit, të kryer nga policia gjyqësore më datë 20.01.2026, ora 16:30, ndaj personit nën hetim **A. . V.**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale **“Vrasje me dashje”** të parashikuar nga **neni 76 i Kodit Penal**.
6. Caktimin si masë sigurimi personal atë të **“Arrest në burg”**, parashikuar nga **neni 238 i Kodit të Procedurës Penale**.
7. Urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Policia Gjyqësore, që në zbatim të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale, të bëjë ekzekutimin e menjëhershëm të këtij vendimi.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda brenda 5(pesë) ditëve, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.01.2026.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

e-mail: ola.ismaili@gjykata.gov.al